



**KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

Dokument parlamentar

RAPORT
(Për dhënie mendimi)

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

“PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË MINAMATËS “PËR MËRKURIN”

➤ **HYRJE**

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës, Komisioni për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin znj. Ornela Çuçi, Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit, znj. Klodiana Baduni, Drejtore e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, znj. Lindita Tafaj, përfaqësuese e Institutit të Shëndetit Publik dhe znj. Nexhila Kodra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Relator për këtë projektligj ishte deputeti z. Andrea Marto.

➤ **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

➤ QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është të finalizojë procesin e ratifikimit të konventës së Minamatës “Për merkurin”, e cila është miratuar, në parim, nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet vendimit nr.663, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave.

Projektligji përbën një kuadër rregullator me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit në vend nga efektet e dëmshme të merkurit, si dhe kontribuon edhe në kufizimin e kontrollin e shkarkimeve të merkurit në nivel global.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje vjen edhe në kuadër të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare që vendi ynë ka në lidhje me adresimin e problematikave për merkurin. Duke qenë se mercuri është një substancë që përfaqëson një kërcënim global kjo marrëveshje synon ta trajtojë këtë problem nëpërmjet një bashkëpunimi të mirë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Pas miratimit në parim të Konventës, në Republikën e Shqipërisë, prej vitit 2016 deri në vitin 2019 është zbatuar projekti “Vlerësimi fillestar i Minamatës”, me mbështetjen financiare të Fondit Global për Mjedisin dhe UNDP.

Nëpërmjet këtij projekti është realizuar vlerësimi i kapaciteteve institucionale për zbatimin e konventës së Minamatës duke hartuar planin e komunikimit me aktorë të interesuar dhe inventarin kombëtar të merkurit, si dhe duke analizuar të gjitha aktet ligjore dhe boshllëqet legjislative që lidhen me prodhimin dhe përdorimin e merkurit në të gjithë sektorët.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të krijojë gjithashtu përfitime në aspektin e ndihmës teknike dhe financiare për shtetin shqiptar, nëpërmjet përfitimit të fondeve për zbatimin e projekteve të ndryshme në këtë fushë, me fokus mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit në vend nga efektet e dëmshme të merkurit, si dhe kufizimin e kontrollit të shkarkimeve të merkurit në nivel global.

Për sa më sipër, si dhe duke vlerësuar zhvillimet e bëra gjatë zhvillimit të projektit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka gjykuar të arsyeshme vijimin e procesit të ratifikimit të Konventës së Minamatës “Për merkurin”.

➤ EFEKTET FINANCIARE

Për sa i takon efekteve financiare konventa thekson se kontributi financiar i vendeve anëtare do të jetë kontribut vullnetar që lidhet me kostot për zbatimin e kërkesave të konventës. Bazuar në eksperiencën e deritanishme me konventa të tjera të ngjashme në fushën e kimikateve dhe mbetjeve të tyre kontributet vjetore të këtij lloji për vendin tonë vlerësohen nga 400 deri në 800 dollarë/vit (maksimumi).

➤ DISKUTIME NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit zëvendësministria Çuçi sqaroi se kjo marrëveshje ka si qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mbrojtjen e mjedisit duke realizuar zvogëlimin e sasive të mërkurit deri në eliminimin e tyre.

Relatori, deputeti Marto ftoi deputetët e komisionit për ta miratuar këtë projektligj, duke theksuar rëndësinë që ka kontrolli dhe zvogëlimi i sasive të mërkurit në shëndetin publik, sidomos sa i takon zonës së Vlorës, si një nga zonat objekt studimi pas mbylljes së fabrikës së sodës kaustike në vitin 1992.

Për gjithë sa më lart, deputetët u interesuan mbi gjendjen aktuale të sasive të mërkurit në vendin tonë dhe mbi efektet e pritshme të kësaj marrëveshje. Zëvendësministria sqaroi se aktualisht në vendin tonë nuk kemi sot një potencial të mërkurit që mund të ndikojë në shëndetin e njerëzve apo të specieve detare. Nga ana tjetër arsyeja pse kërkohet ratifikimi i kësaj marrëveshjeje është parandalimi i problemeve që mund të ndodhin në të ardhmen për shkak të mërkurit.

➤ PËRFUNDIME

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me të gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATOR

ANDREA MARTO

KRYETARE

MIMI KODHELI